

VENDIM
Nr. 884, datë 30.10.2015

**PËR SHPRONËSIMIN DHE MARRJEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM, PËR
INTERES PUBLIK, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË
PREKEN NGA NDËRTIMI I URAVE DHE RRUGËVE HYRËSE TË PROJEKTIT TË
GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK (PROJEKTI TAP)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 7 e 8, të pjesës së parë e të dytë të shtojcës 1, të marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), ratifikuar me ligjin nr. 116/2013, “Për ratifikimin e marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG,” dhe neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i urave dhe rrugëve hyrëse në Fier, Korçë e Skrapar, të projektit të Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), sipas listave bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të shtetit, përfaqësuar nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen dhe merren në përdorim të përkohshëm, të kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit që paraqitet në tabelat bashkëlidhur, për sipërfaqet 7 511.75 (shtatë mijë e pesëqind e njëmbëdhjetë pikë shtatëdhjetë e pesë) m², e cila merret në përdorim të përkohshëm, dhe 3 600.07 (tre mijë e gjashtëqind pikë zero shtatë) m², e cila shpronësohet, me vlerë të përgjithshme prej 6 009 028.03 (gjashtë milionë e nëntë mijë e njëzet e tetë pikë zero tre) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e kompensimit për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm si dhe vlera e shpenzimeve procedurale të përballohen nga shoqëria TAP AG, si subjekti kërkues i këtij shpronësimi.

5. Për likuidimin, për efekt të shpronësimit dhe marrjes në përdorim të përkohshëm, të procedohet, si më poshtë vijon:

a) Për të gjitha pasuritë, për të cilat, në kolonën përkatëse, është bërë shënimi “ZVRPP konfirmon ndryshim midis sipërfaqes së dokumentit nga ajo fakt”, pronarët do të likuidohen pas saktësimit, pranë zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të sipërfaqes që kanë në pronësi, në bazë të dokumentacionit të pronësisë që do të lëshohet nga kjo zyrë;

b) Për të gjitha pasuritë, për të cilat, në kolonën përkatëse, është bërë shënimi “ZVRPP konfirmon se për këtë pronë mungon AMTP”, pronarët do të likuidohen pas plotësimit të dokumentacionit të kërkuar nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, në bazë të dokumentacionit të pronësisë që do të lëshohet nga kjo zyrë;

c) Për të gjitha pasuritë, për të cilat, në kolonën përkatëse, është bërë shënimi “ZVRPP konfirmon se për këtë pronë ka kufizim”, pronarët do të likuidohen pas heqjes së kufizimit të vendosur mbi pronën, në bazë të dokumentacionit të pronësisë që do të lëshohet nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

d) Për të gjitha pasuritë, për të cilat, në kolonën përkatëse, është bërë shënimi “ZVRPP konfirmon se mbi pronën është vendosur garanci kredie”, pronarët do të likuidohen pas heqjes së garancisë së vendosur, në bazë të dokumentacionit të pronësisë që do të lëshohet nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

d) Për të gjitha pasuritë, për të cilat, në kolonën përkatëse, është bërë shënimi “ZVRPP konfirmon se për këtë pronë ka kufizim, pasi ka vendim sekuestro”, pronarët do të likuidohen

pas heqjes së vendimit të sekuestros, në bazë të dokumentacionit të pronësisë që do të lëshohet nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

dh) Për të gjitha pasuritë, për të cilat, në kolonën përkatëse, është bërë shënimi “ZVRPP konfirmon se mbi pronën ka vendim të ndërmjetëm për sigurim padie”, pronarët do të likuidohen pas marrjes dhe sipas vendimit të formës së prerë të Gjykatës si dhe në bazë të dokumentacionit të pronësisë, që do të lëshohet nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme;

e) Për të gjitha pasuritë, për të cilat, në kolonën përkatëse, është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP”, pronarët do të likuidohen në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

6. Çdo pronar, për t’u likuiduar për efekt shpronësimi dhe marrjeje në përdorim të përkohshëm, të dorëzojë dokumentacionin e plotë të pronësisë, vërtetimin nga banka, për numrin e llogarisë dhe IBAN, si dhe kopje të kartës së identitetit pranë shoqërisë TAP AG.

7. Çdo përdorues të likuidohet, për efekt shpronësimi, në bazë të kopjes së dokumentit të identifikimit, vërtetimit nga banka, për numrin e llogarisë dhe IBAN, si dhe certifikatës familjare, që do të dorëzojë pranë shoqërisë TAP AG.

8. Procesi i shpronësimit të fillojë brenda muajit nëntor 2015.

9. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Fier, Korçë e Skrapar, në bashkëpunim me shoqërinë TAP AG, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë që do t’u vihet në dispozicion nga shoqëria TAP AG, si dhe procesin e kalimit të pronësisë dhe marrjes në përdorim të përkohshëm, në favor të shtetit, duke pezulluar të gjitha transaksionet për pasuritë, sipas listave bashkëlidhur këtij vendimi.

10. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, shoqëria TAP AG, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Fier, Korçë e Skrapar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama